

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 471 Prot.

Tiranë, më 05.04 2017

VENDIM Nr. 53, datë 24.03.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5. të datës 24.03.2017, pasi shqyrtoi njoftimin e DRKK – Gjirokastër në lidhje me zbatimin e vendimit të KKA Nr. 120, datë 18.11.2015, për gërmimin e varrit të zbuluar në mënyrë rastësore në fshatin Krahës (Zhulaj), të Tepelenës,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pjesërisht vendimin Nr. 120, datë 18.11.2015 të KKA, në lidhje me pikën II të këtij vendimin ku përcaktohet:
 - Të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit dhe dokumentimi i varrit nga DRKK-Gjirokastër, raporti i të cilit të paraqitet në KKA e radhës,
duke u zëvendësuar:
 - Të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit dhe dokumentimi i varrit nga ASHA, raporti i të cilit të paraqitet në KKA e radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO